



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:208148

Datë: 29.04.2022

Numri i dokumentit: 02973129

**PKR.nr.45/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Merita Xharavina, zyrtare ligjore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Sh. nga Gj., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarit S.M. nga Gj., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.183/2021 të datës 10.03.2022, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me datë 22.04.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, të akuzuarit B.Sh. dhe mbrojtësit të tij, Av. Egzon Doli, si dhe të akuzuarit S.M., me datë 28.04.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 29.04.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të akuzuarit:

B.Sh., me nofkën N., nga i ati T., dhe e ëma R., e gjinisë G., i lindur me..., në Gj., ku dhe tani jeton, rr..., me nr. personal..., ka të kryer tri klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, i martuar, i ati i pesë (5) fëmijëve, rom, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar, gjendet në paraburgim nga data 17.09.2021, dhe

S.M., nga i ati M., dhe e ëma S., e gjinisë Sh., i lindur me..., në Gj., ku dhe tani jeton, rr..., me nr. personal..., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion kamarier, i papunë, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar për veprën penale nga neni 273 të KPK-së,

**JANË FAJTORË**

**I.**

I akuzuari B.Sh.,

Sepse, me datën dt.13.08.2021 rreth orës 20:00 në rr. “Skënderbeu” në Gjakovë, hetuesit e DHTN në Gjakovë, kanë ndaluar të pandehurin S.M. dhe gjatë kontrollit tek i njëjti është gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike e llojit heroinë në peshë prej rreth 0.81 gram, ku pas intervistimit i njëjti në polici ka deklaruar se substancën narkotike të llojit heroinë e ka blerë nga këtu i pandehuri B.Sh. nga Gj. ashtu që ky njësit duke vepruar në bazë të një urdhërese nga Gjykata Themelore-DKR në Gjakovë, nën PN.KR.nr.39/2021 me datë 17.09.2021, rreth orës 09:00, ka bërë kontrollin dhe bastisjen e shtëpisë së të pandehurit B., në rrugën..., dhe gjatë këtij kontrolli është gjetur dhe sekuestruar një qese najloni në peshë prej rreth 15 g, 138 qese të vogla najloni në peshë prej rreth 15g e në to të futura substancë narkotike e cila nga raporti i AKF-së me nr. AKF/2021-2520/2021-2415 të datës 18.10.2021 ka rezultuar të jetë e llojit heroinë me peshë të përgjithshme 26.86 gram, si dhe para në shumë prej 3x10 franga, 1x20 euro, 7x10 euro, 11x5 euro dhe dy telefona mobil të llojit “Samsung”.

Me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

## II.

I akuzuari S.M.,

Sepse, me datën dt.13.08.2021 rreth orës 20:00 në lagjen “Skënderbeu” në Gjakovë, hetuesit e DHTN në Gjakovë kanë ndaluar të pandehurin S.M. dhe gjatë kontrollit tek i njëjti në xhepin e pantallonave i është gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike e cila nga raporti i AKF-së me nr. AKF/2021-2520/2021-2415 të datës 18.10.2021, ka rezultuar të jetë e llojit heroinë në peshë prej rreth 0.81 gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 paragrafi 1 nënpar. 1.4 dhe 1.2, si dhe nenit 267 paragrafi 1 dhe 269 paragrafi 1 të KPRK-së (Kodi Nr. 06/L-074), si dhe neneve 360, 361, 365 dhe 450 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit i:

## GJYKON

### I.

Të akuzuarin B.Sh.,

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 17.09.2021, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar, dhe

Dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) Euro me një (1) ditë burgim.

Ndaj të akuzuarit B. Sh., bëhet konfiskimi i: një qese najloni në peshë prej rreth 15 g, 138 qese të vogla najloni në peshë prej rreth 15 g, e në to të futura substancë narkotike e cila nga raporti i AKF-së me nr. AKF/2021-2520/2021-2415 të datës 18.10.2021 ka rezultuar të jetë e llojit heroinë me peshë të përgjithshme 26.86 gram, si dhe para në shumë prej 3x10 franga, 1x20 euro, 7x10 euro, 11x5 euro dhe dy telefona mobil të llojit "Samsung".

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëjë shkatërrimin e substancave narkotike, të përshkruara si më lart.

Urdhërohet Agjencioni për Administrimin e pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të mbajë pasurinë e luajtshme (parat në shumë prej 3x10 franga, 1x20 euro, 7x10 euro, 11x5 euro dhe dy telefona mobil të llojit "Samsung") të cekur si në dispozitivin e I-rë të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 284 paragrafi 6 të KPPRK-së.

Obligohet i akuzuari i parë, që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë:

- në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, dhe
- në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kryetari i trupit gjykues të akuzuarit B.Sh., ia ka vazhduar masën e paraburgimit, e cila masë nuk mund të zgjasë më shumë se sa dënimi i shqiptuar me burgim.

## II.

Të akuzuarit S.M.,

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, dhe

Dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej pesë (5) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) Euro me një (1) ditë burgim.

Ndaj të akuzuarit S.M., bëhet konfiskimi i: substancës narkotike të llojit heroinë në peshë prej rreth 0.81 gram, si objekt i veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëjë shkatërrimin e substancës narkotike, të përshkruar si më lart.

Obligohet i akuzuari i dytë, që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë:

- në emër të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) Euro, dhe
- në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Pjesa hyrëse e arsyetimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën, PP/I.nr.183/2021 të datës 10.03.2022, ndaj të pandehurve B.Sh. nga Gj., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe S.M. nga Gj., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 22.04.2022, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë marrë pjesë: Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, i akuzuari B.Sh., së bashku me mbrojtësin e tij, av. Egzon Doli me seli në Gjakovë, i angazhuar sipas detyrës zyrtare dhe i akuzuari S.M.

Prokurorja e shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

### 2. Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Kryetari i trupit gjykues pasi është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve i'u ka dhënë mundësinë që ta pranojnë ose të mos e pranojnë fajësinë, por paraprakisht ju ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që për të cilën ngarkohen.

I akuzuari B.Sh., pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar, se: E pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit të parë, avokati Egzon Doli, duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka theksuar se: Pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, mbështetet në provat dhe shkresat e lëndës të përshkuara në aktakuzë. Andaj, meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore i ka propozuar gjykatës që me aktvendim ta pranon pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Mes tjerash, ka shtuar se në rastin konkret si rrethanë lehtësuese për të mbrojturin e tij duhet të jetë fakti se i njëjti që nga fillimi kësaj procedure penale ka shprehur gatishmëri të lartë për bashkëpunim, si me organet e ndjekjes, ashtu edhe me gjykatën, të cilën e ka konfirmuar edhe me pranimin e fajësisë, gjithashtu i njëjti është penduar thellë për veprimet e tij, me ç'rast i ka propozuar gjykatës që meqenëse vepra për të cilën akuzohet është e dënueshme me gjobë dhe me burgim, atëherë sa i përket dënimit me gjobë të përcaktohet në kufijtë minimal që ka paraparë Kodi Penal, ndërsa për sa i përket llojit tjetër të dënimit lidhur me lartësinë apo kohëzgjatjen e tij, gjithashtu të kufizohet në këto rrethana lehtësuese të lartcekura, si dhe në kufijtë minimal ligjor.

I akuzuari S.M., ka deklaruar, se: E pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet, njëherit i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë. Po ashtu ka deklaruar se është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, duke shtuar se është i varur nga droga dhe është duke u shëruar, andaj e ka lutur gjykatën që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit.

### 3. Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, ka deklaruar se: Pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, meqë ky pranim fajësie është në përputhje të plotë me provat mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza. Andaj, gjykatës i ka propozuar që këtë pranim të fajësisë të bërë nga ana e të pandehurve ta aprovon.

### 4. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga nenet 246 dhe 248 par. 1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues duke u mbështetur edhe në pranimin e fajësisë nga ana e tyre, ka aprovuar pranimin e fajësisë së të akuzuarve dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata, ka gjetur se i akuzuari i parë, ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe i akuzuari i dytë, ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtyre faktike e ka marrë në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- raportet e oficerit policor A.B., me nr. të rastit 2021-DHTN-277 të dt.13.08.2021 dhe dt. 17.09.2021;
- vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me nr. të njëjtë të datave 13.08.2021 dhe 17.09.2021;
- procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm me nr. dhe datë të njëjtë;
- fotografitë e substancës narkotike dhe fotografitë e të hollave nga vendi i ngjarjes;
- raporti i shpejtë me nr. të njëjtë, i datës 13.08.2021;
- raport i shpejtë shtesë me nr. dhe datë të njëjtë;
- raporti i oficerit policor A.B., i datës 21.09.2021;
- raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. të rastit 2021-DHTN-277, i datës 20.09.2021;
- fotoalbumi nga vendi i ngjarjes, i datës 17.09.2021;
- raporti plotësues me nr. të njëjtë, i datës 01.03.2022;
- CD-ja bashkangjitur raportit plotësues, të datës 01.03.2022;
- raporti mbi ekzaminim e substancës narkotike të përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë me nr. AKF/2021-2520/2021-2415, i datës 18.10.2021, si dhe
- shkresat tjera në lëndë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimit të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të

përshkruara si në dispozitivin I dhe II, të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpallë fajtorë dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre, me ç'rast përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se të akuzuarit e lartcekur, janë të përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohen.

#### 5. Gjetjet e Gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit si dhe lidhur me konfiskimin

Gjykata, gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69, 70, 71, 72 paragrafi 1 nën-par. 1.4 dhe 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese, për të dy të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar dashjen direkte lidhur me veprat penale, faktin se të njëjtit janë recidivist, pasi që *i akuzuari i parë*, me aktgjykimin PKR.nr.71/2019, i plotfuqishëm me datë 03.07.2020, për vepër të njëjtë penale është dënuar dymbëdhjetë (12) muaj burgim dhe dënim me gjobë treqind (300) Euro, e po ashtu është dënuar edhe për vepër penale të vjedhjes nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa *i akuzuari i dytë*, për vepër penale të natyrës së njëjtë, me aktgjykimin PKR.nr.35/2018, i plotfuqishëm me datë 09.11.2018, me ç'rast është dënuar me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) Euro, dhe për vepra tjera penale të natyrave të ndryshme, e po ashtu edhe faktin se kjo natyrë e veprave penale janë shumë të shpeshta në vendin prej nga janë të akuzuarit.

Gjykata, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin e parë, ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, pasi që i njëjti është i martuar, i ati i pesë (5) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka shprehur gatishmëri të lartë për bashkëpunim, si me organet e ndjekjes ashtu edhe me gjykatën, me ç'rast e ka pranuar fajësinë, pendimin e thellë për veprimet e tij, e posaçërisht si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin se është mbajtës i familjes.

Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin e dytë, po ashtu ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, pranimin e fajësisë dhe sjelljen korrekte gjatë gjyimit, e posaçërisht si rrethanë lehtësuese mori parasysh pendimin e thellë për veprimet e tij.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat të akuzuarit i kanë kryer veprat penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjykata, në kuptim të nenit 267 paragrafi 5 dhe nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 282 paragrafi 1 dhe 2, nën-paragrafi 2.3 dhe 2.5 të KPPRK-së, ndaj të akuzuarit të parë, ka bërë konfiskimin e përhershëm të: një qese najloni në peshë prej rreth 15 g, 138 qese të vogla najloni në peshë prej rreth 15 g, e në to të futura substancë narkotike e cila nga raporti i AKF-së me nr. AKF/2021-2520/2021-2415 të datës 18.10.2021 ka rezultuar të jetë e llojit heroinë me peshë të përgjithshme 26.86 gram, si dhe parave në shumë prej 3x10 franga, 1x20 euro, 7x10 euro, 11x5 euro dhe dy telefona mobil të llojit "Samsung", dhe parat në shumë prej 3x10 franga, 1x20 euro, 7x10 euro, 11x5 euro.

Po ashtu në mbështetje të neneve të cekura si më lart, ndaj të akuzuarit të dytë, ka bërë konfiskimin e substancës narkotike të llojit heroinë në peshë prej rreth 0.81 gram, si objekt i veprës penale.

6. Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.6, lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënpar. 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

7. Arsyet lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.45/2022 datë 29.04.2022**

**Zyrtarja Ligjore,**  
Merita Xharavina

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,**  
Ilir I. Rashkaj

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.